

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

**5.05.2023
Ora 12:39**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **BF (A. Kaziaj, F. Nuri)
PDIU (Sh. Sulo)**
- **Të tjerë:** **KRIIK, ZVA Durrës, përfaqësues të
Bashkisë Durrës, përfaqësues Spitali
Bulqizë**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme kemi në rend dite: projektvendimin për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit; projektvendimin për akreditim vëzhguesish nga disa ambasada; projektvendimet për plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë; shpalljen e vendimit për denoncimin e Qendrës “Qëndresa Qytetare” ndaj Bashkisë Kukës për të dyja rastet; shpalljen e vendimit për denoncimin Qendrës “Qëndresa Qytetare” ndaj Këshillit të Ministrave; kemi vlerësimin e raportimeve të veprimtarive publike të institucioneve

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

publike për periudhën 21 prill – 27 prill 2023 dhe shqyrtimin e denoncimeve përkatëse që i përkasin kësaj periudhe dhe shqyrtimin e disa denoncimeve të tjera nga deputetë të Kuvendit të Shqipërisë të opozitës dhe denoncim të subjektit zgjedhor, koalicionit “Bashkë fitojmë”. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, projektvendimin “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit”.

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para ditës së zgjedhjeve, përveç rasteve, kur për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas përcaktimit të nenit 62, pika 4, të Kodit Zgjedhor. Në referim të dispozitës së mësipërme, Bashkia Durrës ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit nr. 1344/00 dhe qendrës së votimit nr. 1345/00 nga ambienti publik i shkollës 9-vjeçare “Riza Shera” në ambient privat të zotit Dylber Hushi. Arsyetimi i bashkisë për ndryshimin e kësaj qendre votimi është përfshirja e kësaj shkolle në rikonstrukcion dhe për shkak të zëvendësimit të kategorisë DS4 nga tërmeti. Gjithashtu, kryetari i Bashkisë Durrës ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit nr. 1526/00, të qendrës së votimit nr. 1526/01 nga ambienti publik i shkollës së bashkuar Katund i Ri në ambient publik qendra shëndetësore Katundi i Ri. Arsyetimi është për të njëjtin shkak pasi është në program rikonstrukcioni. Bashkia Kamëz ka kërkuar ndryshimin e qendrës së votimit nr. 2040/02 dhe qendrës së votimit nr. 2040/03 nga ambienti privat Sefedin Ahmeti dhe Asim Ahmeti, të cilat janë miratuar me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në datën 31 mars 2023, në ambientin privat të zotit Sadrazem Çerpia. Arsyetimi i bashkisë për të ndryshuar këto dy qendra votimi është sepse pronari i objektit është në kushtet e konfliktit të interesit, pasi është shpallur kandidat i një prej subjekteve politike në

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

listat shumemërore të këshillit bashkiak. Bashkia Gjirokastrë ka kërkuar ndryshimin e qendrës së votimit nr. 4265/00 nga ambienti publik qendra kulturore e shkollës në fshatin Asim Zenelaj në një shkollë nëntëvjeçare. Arsyetimi është pasi ky ambient është i papërshtatshëm dhe i parregullt. Gjithashtu, ka kërkuar ndryshimin e qendrës së votimit nr. 4241 nga ambienti publik shkolla “Vajo Topolli” në qendrën shëndetësore Dunavat. Edhe ky arsyetim është pasi kjo shkollë është e rrënuar. Bashkia Selenicë ka kërkuar ndryshimin e qendrave të votimit nr. 4528/00 dhe nr. 4525/01 nga ambienti i shkollës “Hajredin Beqari” në ambientin publik kopshti i fëmijëve Selenicë. Arsyetimi i bashkisë për ndryshimin e këtyre dy qendrave është mospërfundimi brenda afatit i rikonstruksionit të shkollës së mesme “Hajredin Beqari”. Bashkia Korçë ka kërkuar ndryshimin e qendrës së votimit nr. 3736/00 nga ambienti publik shkolla 9-vjeçare në ambient privat të zotit Irjad Prevulli, me arsyetimin se shkolla është e dëmtuar dhe nuk ka kushte për të shërbyer si qendër votimi. Gjithashtu, ka kërkuar edhe ndryshimin e qendrës së votimit nr. 3736/01 nga ambienti publik i shkollës në ambientin privat të zotit Stavri Ravolli. Bashkia Finiq ka kërkuar ndryshimin e qendrës së votimit nr. 4683/00 nga ambienti publik institucioni publik shkollë në ambientin publik qendra shëndetësore e fshatit Aliko, me arsyetimin se shkolla është e dëmtuar dhe është në fazën e rikonstruksionit. Bashkia Divjakë ka kërkuar ndryshimin e qendrës së votimit nr. 2980/00 nga fshati Karavasta nga ambienti publik shkollë në ambientin e kopshtit me arsyetimin se shkolla nuk është funksionale, nuk ka dyer e dritare. Gjithashtu, ka kërkuar ndryshimin e qendrës së votimit nr. 2982/00 fshati Adriatik, nga ambienti publik shkollë në ambient publik ambulancë, me arsyetimin që shkolla nuk është funksionale, nuk ka dyer e dritare. Bashkia Kuçovë ka kërkuar ndryshimin e qendrës së votimit nr. 3512/00 nga ambienti publik kopsht në ambientin privat të zotit Spiro Tavani me arsyetimin se nga kontrolli i fundit reshjet e shiut e kanë dëmtuar dhe

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

ambienti i propozuar për qendër votimi është bërë papërshtatshëm për të shërbyer për këtë qëllim. Bashkia Mallakastër ka kërkuar ndryshimin e qendrës së votimit nr. 3232/00 nga ambienti i shkollës 9-vjeçare “Gjokë Doçi” në ambientin publik shkollë e mesme e përgjithshme “Hajredin Fratari” me arsyetimin se është dëmtuar nga tërmeti dhe shkolla nuk është funksionale. Bashkia Shkodër ka kërkuar ndryshimin e qendrave të votimit nr. 0236/00, nr. 0236/01 nga ambienti publik shkollë 9-vjeçare Shirokë në ambientin publik qendra shëndetësore Shirokë me arsyetimin se shkolla nuk ka aksesueshmëri dhe nuk plotëson kriteret e ligjit. Ndryshim i qendrës së votimit nr. 0336/00 nga qendra shëndetësore e fshatit Tonçë, Gjon Tuma dhe ndryshimin e qendrës së votimit nr. 341 nga qendra shëndetësore në shkollën 9-vjeçare “Zef Jubani” me arsyetimin se të dyja qendrat shëndetësore janë të mbushura me pajisje mjekësore dhe si ambiente janë të ngushta dhe nuk mund të përdoren si qendra votimi. Gjithashtu, edhe Bashkia Skrapar ka paraqitur kërkesën për ndryshimin e qendrës së votimit nr. 3593/00 nga shkolla e fshatit Zogas të njësisë administrative Qendër të kalojë në ambientin publik shkollë në fshatin Çerenishtë, njësia administrative Qendër, Bashkia Skrapar. Këto janë të gjitha kërkesat për ndryshimin e qendrave të votimit. Pasi janë verifikuar nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, konstatohet se i përmbushin këto kritere. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kemi ndonjë diskutim? Po, përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë fitojmë”.

Z. A. Kaziaj: Faleminderit, zoti Celibashi! Për sa i përket pjesës së orientimit të sekretarit të Përgjithshëm që përmbushin kriteret dhe që ka bërë hetim administrata zgjedhore ose KQZ-ja në këtë rast, do të doja të ishte kështu, por fakti është që bie në kundërshtim me nenin 62, pika 4. Forca madhore duhet vërtetuar në çdo rast. Nuk

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

e di si e ka vërtetuar sekretari i Përgjithshëm. Do të doja shumë që një vendimmarrje e tillë të silllej në vëmendjen përpara këtyre personave që kanë detyra të rëndësishme shtetërore, që të mos abuzojnë në vetvete, nuk po them për të gjithë ata që kanë kërkuar autorizimin, mbase pjesërisht në pjesë të caktuara të tyre vërtet kemi të bëjmë me pamundësi për zhvillimin e zgjedhjeve të këtyre qendrave votimi të paracaktuara, por me atë që është qëllimshmëria e disa kryetarëve të bashkisë që abuzojnë dhe nuk përfillin fare atë që është fryma e ligjit dhe detyrimet e ligjvënësit për këta zotërinjtë që kanë detyra shtetërore të larta. Në pikën 3 të propozimit tuaj ju thoni që kryetarët e bashkive të rinjoftojnë menjëherë zgjedhësit për adresën e re të qendrave të votimit. Do të doja shumë që ky rinjofitim të ishte i vërtetuar dhe të mos kalonte nëpërmjet duarve të patronazhistëve apo të aktivistëve që njoftohen vetëm ata të shtetit dhe qytetarët e tjerë lihen në kategorinë e dytë për shkak se patronazhisti e di se me kë subjekt politik janë dhe nuk njoftohen. Kështu që edhe kjo pikë, që do të jetë vendimmarrja juaj, zoti Celibashi, është shumë e rëndësishme që t'u vihet në dijeni personave. Të hetohet realisht, në qoftë se ka nevojë, për marrjen e masave gjobuese ndaj atyre që kanë abuzuar me detyrën që shteti u ka dhënë. Kam edhe një kërkesë tjetër, të lutem, në qoftë se jashtë rendit të ditës, ai që ishte njoftimi i pak orëve më parë ose i një ore më parë, mund ta shqyrtojmë për shkak të angazhimeve të tjera që kemi. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Dakord me çfarë ju thatë. Të bëhen verifikimet në lidhje me objektivitetin dhe kohën që ka përcaktuar kërkesën për ndryshim të vendndodhjes së qendrës së votimit. Nëse do të verifikohen raste kur janë neglizhuar, të vendosen sanksione, ndërkohë të mbahet në vëmendje edhe çështja e njoftimit të zgjedhjeve për këto qendra votimi. Dakord? Zoti Kaziaj, për cilën pikë të rendit të ditës e kishit fjalën?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Z. A. Kaziaj: Kërkesa ime kishte të bënte me atë që janë dy denoncimet e bëra nga ana e përfaqësuesve të koalicionit tonë lidhur me disa vendimmarrje të këshillit bashkiak Maliq. Kështu që, nëse sekretari i Përgjithshëm e ka relacionin gati lidhur me to...

Z. I. Celibashi: I kemi këtu? Janë këtu. Dakord. Të lutem, Madalena, verifikoji.

Vendimi nr. 444

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

5.05.2023
Ora 12:50

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave të ambasadave Austriake, Greke, Hungareze, Holandeze, Franceze, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Moldavisë, të Delegacionit të Bashkimit European, të Institutit Demokratik të Kosovës për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. P. Doçaj**
- **Parti politike:** **BF (A. Kaziaj, F. Nuri)
PDIU (Sh. Sulo)**
- **Të tjerë:** **KRIIK, ZVA Durrës, përfaqësues të
Bashkisë Durrës, përfaqësues Spitali
Bulqizë**

Z. I. Celibashi: Kalojmë në shqyrtimin e pikës së dytë, që lidhet me kërkesat për akreditim të ambasadave Austriake, Greke, Hungareze, Holandeze, Franceze, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Moldavisë, të Delegacionit të Bashkimit European dhe të Institutit Demokratik të Kosovës.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Ambasadat Austriake, Greke, Hungareze, Holandeze, Franceze, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Moldavisë, Delegacioni i Bashkimit Europian, si dhe Instituti Demokratik i Kosovës kanë paraqitur kërkesat për akreditimin e vëzhguesve për të vëzhguar zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Nga verifikimi i dokumentacioni konstatohet se janë në përputhje me nenin 6, pikat 2 dhe 5, të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte i kërkohet Komisionerit akreditimi i vëzhguesve sipas listës bashkëlidhur. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Miratojmë akreditimin e vëzhguesve të ambasadave Austriake, Greke, Hungareze, Holandeze, Franceze, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Moldavisë, të Delegacionit të Bashkimit Europian dhe të Institutit Demokratik të Kosovës.

Vendimi nr. 445

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 2

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

5.05.2023
Ora 12:52

RENDI I DITËS

*Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave të Televizionit “Top Channel”,
BBF Televizion, Televizioni “Fax Media News”, TV Kopliku, për vëzhgimin e
zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.*

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. P. Doçaj**
- **Parti politike:** **BF (A. Kaziaj, F. Nuri)
PDIU (Sh. Sulo)**
- **Të tjerë:** **KRIIK, ZVA Durrës, përfaqësues të
Bashkisë Durrës, përfaqësues Spitali
Bulqizë**

Z. Y. Merkaj: Kemi edhe disa kërkesa të televizioneve për akreditimin e gazetarëve.
Nëse mundet, i miratojmë, apo do t'i lëmë në fund?

Z. I. Celibashi: Për cilat televizione?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Z. Y. Merkaç: Është Top Channel, Fax Media News, BBF dhe TV Kopliku, që kanë kërkuar akreditim të gazetarëve dhe shoqata KRIIK për akreditimin e 65 vëzhguesve për vëzhgimin e zgjedhjeve.

Z. I. Celibashi: E keni parë dokumentacionin, është në rregull?

Z. Y. Merkaç: Dokumentacioni është në përputhje me ligjin.

Z. I. Celibashi: Atëherë, miratojmë edhe kërkesën e Top Channel, Fax Media News, BBF, TV Koplikut dhe organizatës KRIIK. Dakord.

Vendimi nr. 446, 447

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 21 prill – 27 prill 2023, dhe shqyrtimin administrativ të denoncimeve me nr. 342 ID, 343 ID, 344 ID, 345 ID, 346 ID të deputetes Albana Vokshi, të denoncimeve nr. 347 ID, 348 ID, 349 ID, 350 ID, 351 ID të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, të denoncimit nr. 354 ID të Monitoruesit, të denoncimeve nr. 355 ID, 356, 360 ID, 361 ID, 362 ID, 363 ID të z. Ivi Kaso, të denoncimeve nr. 357 ID dhe 358 ID të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, që lidhen me këtë periudhë monitorimi.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. P. Doçaj**
- **Parti politike:** **BF (A. Kaziaj, F. Nuri)
PDIU (Sh. Sulo)**
- **Të tjerë:** **KRIIK, ZVA Durrës, përfaqësues të
Bashkisë Durrës, përfaqësues Spitali
Bulqizë**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e... E kemi denoncimin?

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e denoncimit dhe me raportimin e vlerësimeve të veprimtarive dhe më pas me shpalljen, meqenëse përfaqësuesit e partive do të largohen.

Znj. M. Koja: Atëherë po vijojmë me pikën e fundit të rendit të ditës. Gjatë periudhës 21 prill-27 prill 2023 në ndërfaqen e raportimeve të veprimtarive publike janë raportuar gjithsej 162 veprimtari nga 50 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto 17 veprimtari janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Jemi në proces shqyrtimi të arsyeve pse ka ndodhur ky fakt, ndërkohë në seancën e radhës do të trajtojmë më pas me vendimmarrje sa u referua. Për sa u përket denoncimeve të administruara që lidhen me këtë periudhë monitorimi, relatojmë si vijon, po e filloj me atë që zoti Kaziaj kërkoi, me denoncues kryetarin e Partisë Demokratike dega Maliq kundër Bashkisë Maliq për miratim aktesh nënligjore. Konkretisht objekt denoncimi është miratimi i vendimit nga këshilli i bashkisë për miratimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe këshillit të qarkut Korçë për qëllim mbrojtjen sociale për të moshuarit. Kryetari i Partisë Demokratike, dega Maliq, pretendon se me këtë vendim janë miratuar fonde buxhetore dhe shtim në numër të punonjësve për ngritjen e një qendre sociale për të moshuarit në njësinë administrative Libonik, duke qenë kështu në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, neni 91, pika 4, i tij. Bashkia Maliq ndërkohë nuk ka dhënë asnjë pretendim, edhe pse është kërkuar informacion për këtë çështje. Gjithashtu, kryetari i Partisë Demokratike, dega Maliq, ka denoncuar sërish Bashkinë Maliq, me objekt denoncimi miratimin e vendimit të këshillit bashkiak për miratimin e dhënies me qira të pasurisë së pafrytshme nr. 597/1, zonë kadastrale

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

3803, me sipërfaqe 65417 metra katrorë në fshatin Loçisht njësia administrative Libonik, si dhe për miratimin për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandarë nr. 711 në fshatin Sovjan, njësia administrative Pirg. Në pretendimet e tij denoncuesi thotë se vendimi që miraton dhënien me qira të tokave bujqësore në përfitim të një kategorie të caktuar banorësh në këto fshatra bëhet brenda periudhës së ndalimit që përcakton Kodi Zgjedhor, konkretisht neni 91, pika 4, dhe neni 92 i tij. Edhe për këtë rast kemi kërkuar shpjegime nga ana e bashkisë, por deri më tani nuk kemi marrë ende pretendimet dhe prapësimet e tyre.

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë fitojmë”.

Z. A. Kaziaj: Faleminderit drejtoreshës! Për sa i përket pjesës së kërimit të shpjegimeve, i keni lënë një afat të caktuar?

Znj. M. Koja: Po, ne u lëmë 2 ditë, 48 orë.

Z. A. Kaziaj: Kur është kërkuar shpjegimi?

Znj. M. Koja: Është kërkuar para dy ditësh. Edhe sot ne presim përgjigje nga ana e tyre.

Z. A. Kaziaj: Edhe sot janë në afat. Deri më sot u keni thënë edhe në rrugë elektronike mund të japin shpjegime?

Z. I. Celibashi: Ua kërkojmë edhe në mënyrë elektronike për të evituar...

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Z. A. Kaziaj: Pra, në rast shpejtësie. Kërkoj nga ana juaj marrjen e masave që të mos kthehem më, sepse ky është një abuzim shumë i madh për të ndikuar drejtpërsëdrejti në adresimin e votës, sepse kjo është shumë e qartë, zoti Komisioner. Këto janë vendime që vetë ata që i marrin, e dinë shumë mirë që po i marrin në shkelje të ligjit. Këto janë vendime jo vetëm të karakterit administrativ të ndaluara në këtë rast nga Kodi Zgjedhor, por janë vendime të abuzimit me detyrën të parashikuara edhe në Kodin Penal, neni 148. Unë habitem sesi këta persona të papërgjegjshëm, duke ditur që ndalimi është i tillë që 4 muaj nga data e zgjedhjeve nuk mundet të merren vendime të kësaj natyre që bien në kundërshtim të hapur me ligjin zgjedhor, marrin përsipër për t'i garantuar subjektit të vet në mënyrë të jashtëligjshme nëpërmjet firmës së vet, abuzime të kësaj natyre duke adresuar votën padrejtësisht në një subjekt nëpërmjet një ushtrimi të pozicionit shtetëror që këta persona kanë, kjo është shumë shqetësuese. Ju e dini fare mirë që të gjitha këto qëndrime të mbajtura janë qëndrime të adresuara dhe të orientuara nga vetë ky subjekt politik, sepse nuk i bëjnë me kokën e vet. Kështu që do të doja nga ana juaj që të mos i linit asnjë sekondë kohë nga ajo që i keni lënë, të merrni masa të menjëhershme dhe më tej ne do ta adresojmë dhe në organet e tjera ligjzbatuese. Faleminderit!

Z. I. Celibashi Po, faleminderit! Atëherë, besoj nesër, në mbledhjen e radhës, do të disponojmë vendim.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, nëse do t'i sjellin sot. Vazhdojmë me çështjet e tjera me denoncimet e tjera.

Z. A. Kaziaj Më fal, zoti Komisioner, më thonë nga administrata që sapo i kanë sjellë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Z. Celibashi Mirë dakord le t'i administrojnë.

Znj. M. Koja: Pra, na informojnë që sapo kanë ardhur do t'i administrojmë dhe nesër do ti bëjmë pjesë të vendimmarrjes.

Z. I. Celibashi: Ideja është për t'u njohur dhe përfaqësuesit.

Znj. M. Koja: Po patjetër do t'ia vendosim në dispozicion.

Z. I. Celibashi : Mirë vazhdojmë me referimin për veprimtarinë e institucioneve për periudhën 21-27 prill dhe denoncimet që lidhen me këtë periudhë, të organizatave apo dhe të subjekteve.

Znj. M. Koja: Atëherë, denoncues është KRIK kundër Bashkisë Tiranë për një veprimtari të zhvilluar pavarësisht ndalimit të bërë nga KQZ. Komisioneri me vendimin numër 367 ka ndaluar një veprimtari të zhvilluar nga Bashkia Tiranë dhe ky ndalim është pasqyruar dhe në faqen e aktiviteteve të ndaluara të KQZ. Bashkia e Tiranës ka parashtruar argumentet e saj. Qartazi nga argumentet e paraqitura del se veprimtaria nuk është i një karakteri publik, por është i një karakteri politik, është pjesë e agjendës politike të kryetarit të Bashkisë, ai ka marrë pjesë në këtë aktivitet si kandidat i Partisë Socialiste në këto zgjedhje, dhe ku kanë qenë pjesëmarrës dhe drejtues të tjerë politik të Qarkut të Tiranës. Nuk kemi të bëjmë me një veprimtari publike të kryetarit të Bashkisë por me një veprimtari partiake politike të kryetarit të Bashkisë. Ndërkohë kemi një denoncim tjetër nga KRIK kundër Bashkisë Kamzë.

Z. I. Celibashi Për këtë periudhë?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Znj. M. Koja: Gjithmonë flasim për këtë periudhë. Bashkia Kamzë vijon me postimet në faqen zyrtare *facebook* të bashkisë, pra poston aktivitetin elektorale të Kryetarit aktual dhe njëkohësisht të kandidatit për kryetarë bashkie në këto zgjedhje si përfaqësues i Partisë Socialiste. I kemi kërkuar sqarimet Bashkisë Kamzë dhe ende nuk kemi marrë sqarimet nga ana e saj.

Z. I. Celibashi Ne e kemi verifikuar këtë që është kështu?

Znj. M. Koja Po e kemi verifikuar.

Z. I. Celibashi Atëherë, nuk ka asnjë arsye për të pritur sqarime do të vendosim që duke urdhëruar Bashkinë Kamzë për të hequr të gjitha postimet që lidhen me aktivitetin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kamzë edhe pse ka qëlluar që të jetë dhe Kryetari i Bashkisë dhe për të sanksionuar personat përgjegjës për këtë shkelje. Kështu që për këtë pjesë e konsideroj të përfunduar hetimin dhe shqyrtimin administrativ dhe vendimmarrja është ajo çfarë shpallëm pak më parë. Po, vazhdojmë.

Znj. M. Koja: Ndërkohë KRIIK ka denoncuar 21 Bashki dhe 16 ministri për përdorim të hashtagëve në faqet e tyre zyrtare të rrjetit social *facebook*. Janë 2 denoncime në fakt të administruara në këtë periudhë për grupe të ndryshme institucionesh janë Bashki 21 dhe 16 ministri. Denoncimi në objekt të tij ka thjesht përdorimin e hashtagëve që janë të fushatës zgjedhore apo që i përkasin Partisë Socialiste.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Z. I. Celibashi: A kemi shembuj të ilustruar, a kemi ndonjë hashtag?

Znj. M. Koja: Po, kemi, është: “Shqipëria e ardhmja jonë”, “S’ka kohë për pushim”, pra këto janë 2 hashtagët e përdorur nga kryetarët e bashkive.

Z. I. Celibashi: Cilët hashtag janë?

Znj. M. Koja: “S’ka kohë për pushim” 14 maj, dhe ato që përmenda pak më lart.

Z. I. Celibashi: I njëjti vendim dhe në këtë rast mendoj, nëse janë të verifikuara. Ne i kemi bërë verifikimet tona?

Znj. M. Koja: Atëherë, provat janë të faktuara në rastin konkret, ne nuk i kemi kërkuar shpjegim, i kemi ftuar të marrin pjesë sot për të dhënë shpjegimet, por nuk kemi ndonjë përgjigje.

Z. I. Celibashi: Atëherë, edhe në këtë rast ato bashki apo dhe institucione të cilat në faqet e tyre zyrtare kanë në përmbajtje të tyre hashtag, të cilët i përkasin një subjekti zgjedhor, detyrohen që t’i heqin nga faqet e tyre dhe personat përgjegjës për këtë rast të sanksionohen administrativisht. Domethënë edhe për këtë kategori denoncimesh e konsiderojmë të përfunduar shqyrtimin dhe hetimin administrativ me vendimmarrjen përkatëse. Kështu që këto vendime do të publikohen dhe do t’u dërgohen palëve. Po, vazhdojmë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Znj. M. Koja Për Bashkinë Sarandë, në fakt, kemi administruar një kërkesë sot për të shtyrë shqyrtimin nga ana e Bashkisë Sarandë, nëse e pranojmë, atëherë e shtyjme shqyrtimin, nëse jo, atëherë do të vazhdojmë.

Z. I. Celibashi: Po, do ta pranoj kërkesën për shtyrjen e seancës për hetimin administrativ përkatës.

Znj. M. Koja: Bashkia Kuçovë, denoncues është zoti Ivi Kaso, veprimtari me përdorim të burimeve publike. Është zhvilluar aktivitet elektoral i kryetarit të Bashkisë Kuçovë dhe njëkohësisht kandidati i Partisë Socialiste për këtë bashki duke përfshirë në të dhe punonjës të bashkisë. Sipas denoncuesit ai ka listuar një listë me emra të përveçëm personash pjesëmarrës në aktivitet ku evidentohet që janë drejtorë, administratorë, mësues, operatorë të institucioneve të tjera. Nga pretendimet që kemi administruar nga kryetari i Bashkisë Kuçovë, kuptojmë që sipas tij ka pasaktësi në lidhje me të dhënat e personave të denoncuar, dhe vendet ku punojnë, apo pozicionet, por nuk jep shpjegime të mëtijshme përtej kësaj. Së dyti, në pretendimet e kryetarit të Bashkësi së Kuçovës, ai parashtron se punonjësit e administratës shtetërore pas orarit të punës kanë të drejtë të marrin pjesë në veprimtari politike ose zgjedhore dhe në vlerësimin e tij nuk ka pasur përdorim të detyruar për pjesëmarrjen të punonjësve në këto veprimtari. Ne i kemi ftuar të vijmë në seancë e shqyrtimit, por nuk kemi informacion nuk kemi konfirmim se do të jenë të pranishëm apo jo në këtë seancë të shqyrtimit. Ndërkohë denoncimi i ardhur nga zoti Ivi Kaso, kundër Bashkisë së Durrësit, Emirjana Sakos, për një veprimtari me mesazhe elektorale takimi elektoral i Kryetares së Bashkisë së Durrësit zonjës Sako, njëherësh kandidate e Partisë Socialiste për këtë bashki me nxënës të arsimit parauniversitar. Në pretendimet e tij denoncuesi thotë se është përdorur në mënyrë të detyrueshme në

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

fushatë zgjedhore nxënësit dhe stafi arsimor duke i nxjerrë më herët nga mësimi. Bashkia e Durrësit në pretendimet e saj thotë se takimet me maturantët që janë votues për herë të parë dhe nxënës të shkollave të qytetit, kryesisht të gjimnazeve “Gjergj Kastrioti”, “Naim Frashëri” dhe “Leonik Tomeo” janë zhvilluar për të diskutuar për projektet e realizuara dhe ata që do të bëhen gjatë mandatit të ardhshëm 4-vjeçar dhe nuk ka cenuar aspak procesin mësimor të këtyre nxënëseve gjë që konfirmohet edhe nga ZVA parauniversitar Durrës. Aktivitetet janë zhvilluar në orën 13.30 me nxënësit e shkollës “Leonik Tomeo” kur mësimi kishte përfunduar në orën 13.05, ndërsa veprimtaria me nxënësit e gjimnazit “Gjergj Kastrioti” dhe “Naim Frashëri” është zhvilluar në orën 18:00 dhe 19:00 kur mësimi përfundon në orën 17:40. Këto aktivitete janë zhvilluar në ambiente publike që frekuentohen nga grup mosha të ndryshme, janë pretendimet e Bashkisë së Durrësit. Ne kemi i kemi thirrur dhe bashkia është pjesëmarrëse në seancë. Nëse duan të shtojnë ndonjë gjë përtej mund të flasin.

Z. Vangjel Manushi, përfaqësues i B/Durrës: Përshëndetje! Ne i qëndrojmë pretendimeve tona të depozituara me shkresë zyrtare njëkohësisht sqarojmë se këto aktivitete janë zhvilluar jashtë orarit mësimor dhe konfirmimi ka ardhur edhe nga Drejtoria Arsimore, e cila është prezent këtu sot.

Znj. A. Thërmija: Përshëndetje! Unë jam drejtoresha e Zyrës Arsimore të Durrësit. Konfirmoj se këto veprimtari të organizuara nga kryetarja e bashkisë nuk kanë cenuar aspak procesin mësimor, janë zhvilluar jashtë procesit dhe jashtë institucioneve arsimore. Dhe unë vetë jam kujdesur që të mos ketë as njëlloj cenimi të procesit. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i koalicionit “ Bashkë Fitojmë”.

Z. F. Nuri: Faleminderit! Lidhur me çështjen denoncimi është publik, është referuar nga zoti Kaso, sikundër e thatë dhe ju, ajo. Që mua më bën përshtypje dhe duhej të ishte nga relatimi çfarë dëgjova, ishte se ishte përdorur togfjalëshi takim me nxënësit votues për herë të parë me qëllim parashtrimin e ideve dhe projekteve për mandatin e radhës, për mandatin e dytë. Kjo është qartësisht politike. Zonja Sako kandidon dhe nuk e ka të sigurtë nëse do të fitojë ose jo, duke dalë dhe duke bërë aktivitet me zgjedhësit me gjimnazistët dhe qëllimin e pranon edhe vetë që qenka pikërisht për të shpalosur idetë e mandatit të dytë kjo do të 3ëshët asgjë më pak se aktivitet politik. Për sa i përket orarit këtë do të duhet të na e provojnë dhe nga foto që janë paraqitur ku është shumë e qartë që është në orar të paradites në shumicën e rasteve. Ndërsa një pyetje kisha: Të cili ambient dhe te cili lokal ka qenë në Durrës i zhvilluar? Mos ka qenë i atij personazhit Noizit që të ka dalë publikisht në mbështetje të kandidatëve të tjerë apo e kam gabim?

Z. Vangjel Manushi, përfaqësues i B/Durrës: Lidhur me sa pretendon pala denoncuese kërkohet që, duke qenë se ka denoncuar, barrën e provës e kanë këta, dhe të vërtetojnë që nuk ka qenë gjatë orarit mësimor, sepse ne e vërtetojmë që ka qenë jashtë orarit mësimor. Ne nuk themi që kandidati për kryetar bashkie nuk do të zhvillojë fushatë politike. Po ai do të zhvillojë jashtë orarit mësimor do të zhvillojë fushatë politike se për atë punë është. Këtë nuk e ndalon asnjë ligj aq më tepër që është jashtë ambienteve të shkollave dhe jashtë orarit mësimor.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Vazhdojmë me relatin.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Znj. M. Koja Atëherë vijmë me denoncimin e zotit Ivi Kaso kundër Bashkisë së Lushnjës për një veprimtari publike me mesazhe elektorale. Në pretendimet e tij, në fakt, zoti Kaso thotë që bashkia nuk është pajisur me leje zhvillimore për organizimin e një veprimtarie publike panairi “Ditët e bujqësisë 2023”. Në pretendimet e bashkisë ne kemi administruar këto prapsim, aktiviteti panairi, ditët e bujqësisë 2023 është rikthyer në Lushnjë në datat 27, 29 prill. Ky panair u organizua nga Iceberg Exhibition në bashkëpunim me bashkinë e Lushnjës. Organizimi i këtij ishte parashikuar më herët në kalendarin e aktiviteteve në të vitit 2023 dhe bëhet për të dytin vit radhazi. Data e zhvillimit nuk është caktuar nga bashkia por nga kompania që e ka organizuar. Bashkia pretendon se kjo veprimtari është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së në muajin shkurt. Nga verifikimet tona ajo nuk është raportuar, nuk rezulton e raportuar. I kemi kërkuar shpjegime të mëtjshme, i kemi ftuar në seancën e sotme dhe kemi marrë një imail ku bashkia thotë se nuk do të jemi të pranishëm, por i qëndrojmë prapësimeve të depozituara më herët.

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me relatimin e denoncimeve të tjera.

Znj. M. Koja Ka sërish një denoncim ndaj Bashkisë së Durrësit dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar të Durrësit, nga zonja Albana Vokshi, deputete e Kuvendit të Shqipërisë. Është takimi i kryetares me nxënës të arsimit parauniversitar. Në pretendimin e denoncuesit thuhet se zonja Sako ka organizuar takimin elektorale me nxënës të arsimit parauniversitar aktivitet që e ka deklaruar vetë publikisht. Pretendohet se janë vetë qytetarët dhe nxënësit që e kanë raportuar daljen më herët nga mësimi. I kemi kërkuar informacion të mëtjshëm palëve që të na japin prova dhe fakte të tjera, nuk e provojmë dot nëse bëhet fjalë për të njëjtin aktivitet të denoncuar edhe nga zoti Kaso. Gjithsesi, jemi ende në fazën e shqyrtimit

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

dhe hetimit administrativ edhe për këtë rast. Kemi një denoncim nga zonja Albana Vokshi.

Z. I. Celibashi: Meqenëse janë përfaqësuesit nëse dëshirojnë të flasin për këtë çështje.

Z. Vangjel Manushi, përfaqësues i B/Durrës: Kemi të bëjë me të njëjtën denoncim dhe për të njëjtat orare dhe të një njëjtin aktivitet.

Z. I. Celibashi: Është e njëjta çështje.

Z. Vangjel Manushi, përfaqësues i B/Durrës: Është e njëjta çështje, por janë dy denoncime, për të njëjtën çështje. Faleminderit!

Znj. M. Koja: Zonja Albana Vokshi dhe zoti Ivi Kaso kanë bërë denoncime për të njëjtin rast, drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Bulqizë, i denoncuar është zonja Festime Mjeshtri me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor të Bulqizës, kandidate për kryetare të Bashkisë së Bulqizës. Bashkia e Bulqizës, objekt denoncimi është përfshirja e punonjësve të administratës së shëndetit publik në veprimtari për qëllime elektorale. Si prova bashkëlidhur denoncuesit kanë vënë në dispozicion foto të printuara nga rrjeti social facebook, i zonjës Festime Mjeshtri, si dhe një intervistë të dhënë nga kjo e fundit në një gazetë. I ehte kërkuar informacion nga ana e KQZ-së në via imail palëve, por deri më tani nuk kemi marrë asnjë përgjigje. I është kërkuar informacion me imail Drejtorisë së Shërbimit Spitalor të Bulqizës. Kjo e fundit ka kthyer përgjigje ku shprehet se zonja Festime Mjeshtri është aktualisht punonjëse Drejtorisë së Shërbimit Spitalor të Bulqizës me detyrë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

drejtore, është bashkëlidhur urdhri i emërimit. Zonja Mjeshtri kandidon për kryetare e Bashkësi së Bulqizës për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023. Por në këtë periudhë ajo ka dërguar pranë zyrës së burimeve njerëzore kërkesën për leje të zakonshme për vitin 2023 dhe është dokumenti bashkëlidhur dhe miratimi që i është bërë për të marrë lejen e zakonshme. Fushata zgjedhore është bërë gjatë periudhës së lejes zakonshme për vitin 2023 të miratuar konkretisht për kandidaten. Në lidhje me pretendimet e denoncuesit, zonja Mjeshtri ka bërë fushatë për zgjedhjet e 14 majit gjatë kohës që ka qenë dhe është më leje të zakonshme dhe jashtë ambienteve të institucionit dhe nuk ka bërë fushatë gjatë orarit të punës. Jemi në fazën e shqyrtimit dhe përfundimit të hetimit edhe për këtë rast.

Z. I. Celibashi: Ju, kë përfaqësoni?

Z. J. Alliu: Jonus Alliu, nëndrejtor i spitalit të Bulqizës. Zonja Mjeshtri nuk është këtu, dhe nuk është drejtuese e Drejtorisë së Shëndetit Publik, në fakt, është drejtore e spitalit të Bulqizës. Sipas ankimit, se gjoja ka bërë fushatë me punonjësit e administratës, në asnjë rast zonja Mjeshtri nuk ka bërë fushatë brenda orarit zyrtar, madje për këtë jemi mbledhur para se të fillojë, duke i njohur mirë këto punë. Në asnjë rast nuk është bërë asnjë lloj takimi, janë bërë vetëm jashtë orarit zyrtar të punës. Gjatë kësaj kohe, zonja Mjeshtri është edhe me leje të zakonshme, gjë që e lejon të bëjë fushatë. Jua them me garanci të plotë se në asnjë rast zonja Mjeshtri nuk ka bërë fushatë me punonjësit e administratës të shëndetit publik.

Z.I.Celibashi: Ju faleminderit!

Z. J. Alliu: Shumë faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me relatimin.

Znj. M. Koja: Denoncues kemi zonjën Albana Vokshi kundër Bashkisë së Durrësit. Të denoncuar janë zonja Mirjana Sako, Partia Socialiste, Bashkia e Durrësit. Objekt denoncimi është lënia e mjeteve të luajtshme, fadroma të parkuara te shtabi i kandidatës në gatishmëri për përdorim, shtrim të rrugëve në këmbim të votës. Në pretendimin e denoncuesit raportohet se fadromat i parkojnë te shtabi i kandidatës, njëherazi të kryetarit të bashkisë. Sipas denoncimit të ardhur, këto mjete i mbajnë në gatishmëri dhe ky përbën abuzim me postin. Bashkia e Durrësit i ka sjellë këto pretendime, i është dërguar *email* nga ana e tyre dhe është sqaruar si vijon: “Në bazë të ligjit bashkitë janë përgjegjëse për territorin në juridiksionin e tyre për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimin rrugor të parqeve dhe shesheve publike vendore. Këto janë detyra funksionale të ndërmarrjes “Rruga”, të cilat ushtrohen në çdo kohë, në çdo rrugë të qytetit dhe të njësive administrative të tij, pavarësisht se jemi në fushatë zgjedhore apo jo. Gjithashtu, ju informojmë se punimet në rrugë nuk kryhen vetëm nga ndërmarrja “Rruga”, por edhe nga operatorët ekonomikë”. Pra, sipas Bashkisë së Durrësit ky denoncim nuk qëndron. Mund të vazhdojnë të thonë diçka palët, meqë janë përfaqësuesit e Bashkisë së Durrësit?

Z. Vangjel Manushi, përfaqësues i B/Durrës: Nuk kam për të shtuar, përderisa as pala denoncuese nuk ka paraqitur material, dhe kjo e vërteton një gjë të tillë. Mjetet mund të qëndrojnë kudo, shtabe elektorale ka kudo, jemi në fushatë elektorale, mjetet kanë logo po të jenë të bashkisë. Ta vërtetojnë, ta demonstrojnë dhe të vazhdojmë shqyrtimin.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Z. I. Celibashi: Pra, nuk qëndron ky pretendim.

Z. Vangjel Manushi, përfaqësues i B/Durrës: Patjetër që nuk qëndron dhe e kundërshtoj.

Z. I. Celibashi: Dakord.

Znj. M. Koja: Denoncimi i zonjës Albana Vokshi dhe Ivi Kaso kundër zyrës vendore arsimore të Rrogozhinës dhe Partisë Socialiste të Shqipërisë. Shantazhim i mësuesit për të marrë pjesë në takimet elektorale të PS-së. Në pretendimin e denoncuesve shprehet se në datën 20.04.2023 në faqen elektronike “Ballkan Ëeb” është publikuar denoncimi i bërë nga kandidati i koalicionit “Bashkë Fitojmë” për Bashkinë e Rrogozhinës, Shkëlqim Hoxha, i cili ka publikuar mesazhet që vërtetojnë presion dhe kërcënimet ndaj mësuesve, që refuzojnë të marrin pjesë në takimet elektorale të Partisë Socialiste, të cilët kërcënohen me largim nga puna duke kryer veprimtari për qëllime zgjedhore, në kundërshtim me dispozitat ligjore. Kemi marrë një *email* nga ZVA-ja e Rrogozhinës dhe për shkaqe objektive na thonë që sot nuk mund të paraqiten në seancë publike. Të tjera pretendime nuk kemi nga palët.

Z. I. Celibashi: Po dëshirojnë të paraqitet të japë shpjegime?

Znj. M. Koja: Ata kanë thënë që thjesht sot nuk mund të paraqiten. Ne në vlerësimin tonë ose e shtyjme shqyrtimin ose presim të na sjellin pretendimet me *email*.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.05.2023*

Z. I. Celibashi: Po, mirë ju kërkohet të sjellin shpjegime me *email*, përndryshe ju lemë edhe një ditë tjetër, ku të paraqiten në një seancë tjetër, nëse duan që t'i prezantojnë përpara në seancë publike shpjegimet e tyre.

Znj. M. Koja: Sërish kemi denoncim nga zoti Ivi Kaso, Albana Vokshi kundër Bashkisë së Kukësit. Të denoncuar janë Bashkia e Kukësit, zyra vendore e arsimit parauniversitar në Kukës dhe Partia Socialiste. Në objekt denoncimi zoti Gjici ka promovuar në rrjetin social *Facebook* punime të kryera nga Drejtoria e Rrugëve, takime me stafin dhe nxënësit e gjimnazit "Havzi Nela", takime me stafet e kopshteve dhe çerdheve, publikim në media të fotove dhe videove të shpërndarjes së ndihmave për familjet në nevojë. Këto janë veprimtari të kryera me qëllime zgjedhore, në kundërshtim me dispozita ligjore. Janë konstatuar rreth 28 raste të veprimit në kundërshtim me ligjin. Kemi kërkuar informacion *via email*, dhe në datën 29.04 kemi marrë një përgjigje se kjo shkollë ndodhet në rikonstrukcion nga Bashkia e Kukësit. Punimet, të cilat datojnë që në nëntor të 2022-shit, takimi i nxënësve me kryetarin e Bashkisë ka ardhur në kuadër të nismave të ndërmarra nga nxënësit e kësaj shkolle. Takimi është zhvilluar gjatë muajit janar në formën e një bashkëbisedimi ndërmjet këtyre të rinjve dhe stafit të Bashkisë së Kukësit. Këto janë çfarë kemi marrë si prapësime nga ana e Bashkisë së Kukësit.

Vendimi nr 441, 442, 443, 450

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.05.2023*

**05.05.2023
Ora 13:23**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shpalljen e vendimit mbi denoncimin nr. 335 ID, të qendrës
“Qëndresa Qytetare” ndaj Bashkisë së Kukësit dhe zotit Betim Lushi, drejtor i
shkollës “Isuf Seferi”**

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi i KQZ-së: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. P. Doçaj.**
- **Parti Politike:** **BF (F. Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIIK, ZVA Durrës, spitali i
Bulqizës, Bashkia e Durrësit**

Znj. M. Koja: Mund të vijojmë tani me shkallën e vendimeve. Këto janë vetëm ato raste që ne i raportojmë sot në kuadër të denoncimeve të administruara për periudhën e raportimit 21 prill - 27 prill 2023. Ndërkohë sot në rendin e ditës kemi dhe shpalljen e 3 vendimeve. Konkretisht është vendimi me denoncues Qëndresa Qytetare kundër Bashkisë së Kukësit, kryetarit të bashkisë zotit Safet Gjici, zonjës Dallëndyshe Bici, drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, zotit Dëfrim Korbi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë e Kukësit dhe zotit Betim Lushi, drejtor i shkollës 9 –vjeçare “Isuf Seferi” në Kukës. Takimi është zhvilluar në ambientet e oborrit të shkollës “Isuf Seferi” në fshatin Fshat, në njësinë administrative Gryk Çaji e kandidatit të Partisë

*Zbardhi materialin audio
Enida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.05.2023*

Socialiste për Bashkinë e Kukësit, njëherazi kryetari i bashkisë, zoti Gjici, Dallëndyshe Bici, drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në banorë të zonës. Në pretendimet e saj Qëndresa Qytetare shprehet se në ndërfaqen e raportimeve nuk rezulton të jetë raportuar dhe, në fakt, kjo veprimtari nuk mbart detyrim për t'u raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Këto takime janë zhvilluar në ambientet e një shkolle, pronë publike nga subjekti i ngarkuar me detyra, siç është kryetari i bashkisë, zoti Gjici, dhe drejtorja e Agjencisë Shtetërore e Kadastrës me qëllime zgjedhore. Pra, kemi të bëjmë me përdorim të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Janë përdorur fjalime politike, thirrje elektorale duke promovuar kandidatin e Partisë Socialiste. Në pretendimet e saj bashkia shprehet se është takim politik i organizuar në kuadër të fushatës zgjedhore dhe është publikuar në rrjetet sociale të kryetarit dhe të kandidatit. Në pretendimet e saj Agjencia Shtetërore e Kadastrës shprehet se kjo është një veprimtari dhe ajo perfrazon se ç'konsiderohet veprimtari publike kur ajo pasqyrohet në radio, televizion, shtyp, faqe interneti etj, në çdo mënyrë komunikimi. Nga institucioni ynë nuk është organizuar asnjë veprimtari publike pasi prania e zonjës Bici në këtë takim nuk lidhet me detyrën e saj funksionale si drejtore e Përgjithshme e ASHK-së, por si një vizitë e saj pranë miqve dhe familjarëve në vendin e origjinës jashtë orarit zyrtar të punës, e cila ka përkuar me ditën e organizimit të këtij takimi. Për më tepër, nuk është kryer asnjë shkelje pasi në këtë takim rastësor nuk janë bërë shpërndarje apo premtime publike, leje legalizimi apo çdo lloj tjetër pronësie, që janë objekti i punës së zonjës Bici. Zyra vendore e arsimit në Kukës për shkollën "Isuf Seferi" pretendon se nuk ka dijëni për zhvillimin e këtij takimi në ambientet e shkollës 9-vjeçare. Ndërkohë i janë drejtuar edhe drejtorit të shkollës, por nga ana e tij nuk ka një reagim. Në rastin konkret ne sugjerojmë si vijon: rezulton e provuar se veprimtaria me karakter

*Zbardhi matërialin audio
Enida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.05.2023*

elektoral është kryer në ambientet e jashtme të institucionit publik, konkretisht shkollës-9 vjeçare “Isuf Seferi”. Rezulton..

Z. I. Celibashi: Më fal, ne kemi patur vetëm një çështje për të diskutuar, nëse edhe në rastin e dytë është organizuar veprimtaria në shkollë, se ishte çështje diskutimi.

Z. M. Koja: Atëherë kemi 2 veprimtari të zhvilluara në të njëjtën datë. Janë në datën 16 prill 2023, që ka qenë ditë e diel. Janë të njëjtët pjesëmarrës. Në ndryshim nga rasti i dyti, në rastin që unë sapo relatova, në shkollën “Isuf Seferi” provohet që në ambientet e jashtme të shkollës, pra, në oborrin e shkollës, i rrethuar, është zhvilluar fushatë elektorale, ndërsa në rastin,,

Z. I. Celibashi: Për këtë rast do të vendosim sanksione për personat përgjegjës, në rastin tjetër kur shkolla...

Vendimi nr. 439

*Zbardhi materialin audio
Enida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.05.2023*

**05.05.2023
Ora 13:25**

RENDI I DITËS

6. Projektvendim “Për shpalljen e vendimit mbi denoncimin nr. 336 ID, të qendrës “Qëndresa Qytetare”, ndaj Bashkisë së Kukësit dhe zotit Rustem Dervishi, drejtori i shkollës “Shaban Murati”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ:**
 - **Parti Politike:** **BF (A.Kaziaj, F. Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Znj. M. Koja: Po është shkolla “Shaban Murati” në Kukës. Oborri i shkollës nuk ka një mur rrethues, ai është ambient ndihmës i shkollës, por nga sa provohet drejtori i shkollës nuk mund të kishte dijeni, pra nuk ka nevojë për të pasur një lejim nga ana e tij për të aksesuar, pra është aksesuar.

Z. I. Celibashi: Aty kanë qenë pjesëmarrës edhe nxënës, nëse nuk gabo, apo mësues.

Znj. M. Koja: Aty ka qenë pjesëmarrës elektorati. Ne nuk i evidentojmë dot nëse janë mësues apo janë pjesë e administratës së bashkisë, apo persona të tjerë.

*Zbardhi materialin audio
Enita STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.05.2023*

Z. I. Celibashi: Megjithatë, edhe për rastin konkret pasi është evidente që është zhvilluar në ambientin funksional përreth shkollës, jemi përpara shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor, në lidhje me përdorimin e aseteve publike, kështu që edhe për këtë rast do të vendosim sanksione.

Znj. M. Kajo: Ne mendojmë, po patjetër.

Z. I. Celibashi: Kështu që për të dyja rastet, se përndryshe nëse do të ishte veprimtari publike, do të duhet të ishte raportuar. Nuk është veprimtari publike, është veprimtari politike e zhvilluar në një ambient publik, ku nuk duhej zhvilluar, sikurse është shkolla. Po.

Vendimi nr. 440

*Zbardhi materialin audio
Enida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.05.2023*

**05.05.2023
Ora 13:28**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shpalljen e vendimit mbi denoncimin nr. 337 ID, të qendrës
“Qëndresa Qytetare”, ndaj Këshillit të Ministrave”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ-së: **Z. Y. Merkaaj, Znj. M. Koja,
Znj. P. Doçaj.**
- **PARTI POLITIKE:** **PF (A. Kaziaj, F. Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIIK, përf. ZVA Durrës, Bashkia
e Durrësit, spitalit të Bulqizës**

Znj. M. Kajo: Dhe shpallja e vendimit të fundit për rendin e ditës së sotëm është denoncimi i Qëndresës Qytetare kundër Këshillit të Ministrave. Objekt është miratimi i vendimit për shpërblimin e pensionistëve për vitin 2023, i marrë më 31 mars 2023. Në seancën e kaluar Këshilli i Ministrave ishte i pranishëm dhe dha pretendimet e tij, i cili është një akt në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe nuk bie në kundërshtim me asnjë prej pikave të tij. Nga sa kemi administruar si prova, në relacionin shoqërues të vendimmarrjes cilësohet konkretisht që vendimi është marrë ose, le të themi, efekti financiar është i parashikuar në ligjin nr. 84/2022 për buxhetin e vitit 2023. Pra, fondet janë vënë në dispozicion përpara periudhës të ndalimit, për më tepër, që në kuptim të Kodit Zgjedhor nuk ka ndalim specifik për miratimin e akteve, për kategori të caktuara të popullsisë, për periudhën e

*Zbardhi materialin audio
Enida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.05.2023*

zgjedhjeve vendore. Kështu që në këto kushte, ne sugjerojmë që të pushohet hetimi administrativ pa shkelje në rastin konkret.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, ne sikurse jemi shprehur edhe në rastet e tjera të ngjashme, kur është diskutuar për materiale të tilla, nuk jemi në kushtet e shkeljes së Kodit Zgjedhor, për më tepër, në rastin konkret flitet për një vendimmarrje, fonde të cilat janë të përcaktuara në ligjin për buxhetin e shtetit dhe në programin buxhetor të qeverisë. Tej kësaj nuk kemi asnjë arsye për të bërë komente dhe vlerësime të tjera, kështu që do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ për kërkesën për sanksione ndaj Këshillit të Ministrave dhe sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

Vendimi nr. 438

*Zbardhi materialin audio
Enida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.05.2023*

5.05.2023
Ora, 13:30

RENDI I DITËS

*Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë së
Gjirokastrës, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të
Shqipërisë, zotit Klaudio Engjell Imeraj”*

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi i KQZ-së: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. P Doçaj.**
- **Parti Politike:** **BF (F. Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIIK, përf. ZVA Durrës, Bashkia
e Durrësit, spitali i Bulqizës.**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës që kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë.

Z. Y. Merkaj: Po, faleminderit! Këshilli i Bashkisë së Gjirokastrës ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zoti Asllan Bashkim Karagjozi, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Referuar nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për këshillin e Bashkisë së Gjirokastrës, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor liste zoti Klaudio

*Zbardhi materialin audio
Enida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.05.2023*

Ëngjëll Imeraj, i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e deklarimit dhe nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka të deklaruar asgjë që ka të bëjë me ndalimet e parashikimeve të ligjit nr. 148 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore, kur në përgjigjen e kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka verifikuar të dhënat e kandidatit, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime të gjendjes civile. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimet e gjendjes gjyqësore, ku konstatohet se kandidati nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2 kreut 5 të vendimit nr. 7 të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të këshillit të Bashkisë së Gjirokastrës nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, dakord, atëherë vendosim plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë së Gjirokastrës me kandidatin nga lista shumememore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, zotin Klaudio Ëngjëll Imeraj.

Vendimi nr. 448

*Zbardhi materialin audio
Enida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.05.2023*

05.05.2023
Ora 13:32

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë së Pogradecit,
me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zoti
Kristi Leonard Alla.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. P Doçaj.**
- **Parti Politike:** **S’ka.**
- **Të tjerë:** **KRIK, përf. ZVA Durrës, përf. B.
Durrës, spitali i Bulqizës.**

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë së Pogradecit ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zoti Edlir Zyber Dervishi, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Referuar nenit 164 pika 2 të Kodit Zgjedhor kandidati vijues në listën shumemërore të Partisë Socialiste për këshillin e Bashkisë së Pogradecit, të cilit i kalon mandati i këshilltarit dhe është kandidati me numër rendor 23, zoti Kristi Leonard Alla, i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e deklaramit. Nga verifikimi i këtij formulari rezulton se nuk ka deklaruar si të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalimet në ligjin nr. 148 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore, kur në

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.05.2023*

përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje nëse Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka bërë verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar më vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte referuar pikës 2 të kreut 5 të vendimit nr. 7 të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të këshillit të Bashkisë së Pogradecit nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, atëherë vendosim miratimin plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë së Pogradecit me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste Shqipërisë, zotin Kristi Leonard Alla. Përfunduar me të gjitha çështjet në rendin e ditës. Seanca mbyllet. Faleminderit ditë të mbarë!

Vendimi nr. 449

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

